

KËRKESË
Nr. 1660, datë 23.3.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i projektit, “Rikonstruksion dhe shtesë të Teatrit “Andon Zako Çajupi” Korçë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Korçë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të

përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 2.477,604 (dy milionë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e katër) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN

Për projektin "Rikonstruksion dhe shtesë të Teatrit 'Andon Zako Çajupi' Korçë"

NR	EMER E MBIEMER	ZONA KADASTRALE	NR PASURIE	LLOJI I PRONES	SIPERFAQE M2	VLERA ME PREVENTIV	ADRESA E PRONARIT	SHENIM
1	Shpatore Bejko	8561	4/10-N15	Njesi sherbimi	50.19	1,719,652	Lagja Nr.9 Sheshi i Teatrit Nr.35 H.5 Korce	Konfirmuar nga ZVRPP
2	B/P Thanas, Dionis, Varvara, Pandeli, Martin, Zhuljeta, Sofika, Venijamin Napuce	8561	4/10-N1	Njesi sherbimi	18	757,952	Lagja Nr.3 Rruga Gjako Koroveshi Nr.19 Korce	Konfirmuar nga ZVRPP
SHUMA :						2,477,604		

